

Ruli: Atletika është gjallë, po thyhen rekordet e plejadës së artë



Atletika Shqiptare po përjeton një fazë rikompozimi me mjaft probleme, diktuar nga investimi i paktë i shtetit në lëmën e sportit, por edhe nga rënia e përgjithshme e interesit të rinisë, diktuar nga politikat e dobëta sportive të qeverive shqiptare pas vitit 1990. Natyrisht që në këtë fazë tranzicioni atletika ka pasur dhe momentet e saj të mira, por janë pak për të thënë se kemi atletikë cilësore. Gjithsesi, kohët e fundit ka pasur përpjekje për rritje të rezultateve nga elementë të veçantë në disiplina të veçanta, gjë që ka sjellë dhe rezultate të mira në disa disiplina e për më tepër thyerje rekordesh që qëndronin prej 20 e më shumë vitesh. Ashtu siç ndodh

rëndom në Shqipëri, edhe këtu rezultatet shpesh janë kritikuar, për shkak të mungesës së parametrave elektronikë në matje apo dhe dyshimit për falsifikim. Për të pasur një nivel më të lartë të atletikës tonë dhe për ta bërë atë pjesë të pandarë të atletikës europiane e botërore, Federata Shqiptare e Atletikës ka nxituar të organizojë vitet e fundit disa veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare, që kanë patur një efekt pozitiv në imazhin e “mbretëreshës” tonë. Presidenti i FSHA-së, Gjergj Ruli, duke folur për këto nisma, tha se ndihej krenar për atë çfarë është bërë deri tani, por pranoi se infrastruktura e atletikës lë për të dëshiruar. Ai kujtoi se qeveria nuk e mbajti premtimin e saj për një pistë në kryeqytet, ashtu sikurse tha që kritikantët për rezultatet të larta në sajë të dopingut janë të pavërtetë. Për Rulin atletika ka nevojë të mbështetet e jo të atakohet, ajo është e gjallë dhe po thyen rekordet e plejadës së artë të 20-30 vjetëve më parë. Në këtë intervistë të fundjavës, Ruli flet dhe për probleme e tjera që shqetësojnë aktualisht atletikën shqiptare.

Shpesh atletika merr kritika për shkak të gjendjes së rëndë në infrastrukturë, por nisur dhe nga niveli i saj i performancës ndër vite, në një sens krahasimor, si është realiteti?

Unë jam super i ndërgjegjshëm se, njëlloj si në një familje, edhe në atletikë ka probleme. Jo gjithmonë jemi të kënaqur e jo të gjithë mund të kënaqen. Lidhur me pyetjen tuaj mund të them se niveli i atletikës..., shiko, varet në çfarë këndvështrimi e trajton. Ardhja e demokracisë solli gjëra të mira, por solli dhe një dëmtim e degradim të terreneve sportive. Sidomos e rëndë situata ishte në vitet 1994-1996, kur menduam se atletika edhe mund të humbiste fare. Ishin disa filiza të atletikës së kohës së para 90-s, por edhe një grup trajnerësh që e mbajtën gjallë. Këta filiza të rinj kishin ardhur nga ambienti që kishte prodhuar garda e vjetër në atletikë, si Evro, Toska, Vejkollari, Duka etj. Por këta sportistë elitare e ndërprejnë aktivitetin e thujse të gjithë u larguan

për një jetë më të mirë. Pra pati një handicap pasojat e të cilit janë evident. Impakti i atyre viteve solli varfëri në atletikë dhe me një infrastrukturë të rrënuar. Atletika në këta vite humbi themelin bazë të saj: prodhimin e sportistëve në shkolla. Pra humbi sporti i shkollës, që kishte prodhuar sa e sa kampionë. Me pak fjalë në atë kohë (pas vitit 1990) u prish struktura organizuese për atletikën. 25% e shkollave të Tiranës bënë atletikë, kishin dhe bazë materiale përkatëse. Në ditët e sotme duhet të jetë kusht kthimi i sportit në shkollë. Që të jemi realistë, edhe media e shkruar e vizive i kushton shumë pak hapësirë atletikës.

Sidomos infrastruktura është jashtë çdo lloj standardi dhe një pengesë e madhe për të pasur atletikë të zhvilluar apo jo? Dhe nuk është fjala vetëm për pistën e “Qemal Stafës”?

“Qemal Stafa” është e vetmja arenë ku është prezantuar sporti ynë. Ai është si muze. Për të ka dokumentarë nostalgjie. Vetëm në Shqipëri mund të ndodhë të priset një arenë e tillë me kaq histori. Për mendimin tim, ky është një alarm i madh dhe kambanat duhet të bien për ata që marrin vendime.

Dekada më parë ka pasur goxha suksese në atletikë, sot nuk është kjo jehonë. Pse?

Po të krahasojmë atletikën e tanishme me atë të mëparshmen, mund të them se ka përmirësime, sidomos në cilësi. Nuk është rritur volumi, por ka rritje rezultatesh. Është shkruar shpesh se në atletikë janë akoma rekordet e mëparshme. Jo nuk është e vërtetë. Shumica e rekordeve të vendosura në ato vite, që quhen të arta, janë thyer sot. Është e turpshme të thuash nuk kemi atletikë kur janë thyer rekordet. Në atë periudhë shteti ishte mbështetës i madh për sportin, kurse sot rezultatet thjesht po thyhen falë vullnetit të vetë sportistëve, pasi shteti nuk suporton aq sa kemi nevojë. Në atë periudhë ka pasur një brez atletësh që shënuan rezultate të larta. Një ndër ta kam qenë dhe vetëm, me një rekord që qëndroi shumë vite në kërcim së gjati. Por rekordi im u thye. Edhe rekordi i Toskës u thye. Edhe i Evros u thye dhe kanë mbetur shumë pak rezultate që kanë mbetur në arkiv si rekorde. Natyrisht nuk është ndonjë arritje e madhe e atletikës, por fakti që janë thyer rekordet tregon se ka progres. Atletika s’ të lë të gënjesht. Nuk ka aludime, pasi ka rezultat dhe datë. E gjithë veprimtaria është aty, në buletin. Progresi krahasuar me vitet 2005, ose dhe më parë, 2004 apo 2003, është në të gjitha parametrat. Kishim më herët vetëm një bateri në 100 metra, sot kemi 6 bateri. Në kërcim së gjati kemi 15 konkurrentë dhe ka kualifikim për në finale. Kuptohet që ka dhe gara me probleme, por sportistët janë të lirë të zgjedhin disiplinat ku ndihen më mirë.

Të flasim pak hapur. Ka pasur kritika herë pas here në lidhje me rezultatet e larta, që mund të jenë shënuar në aktivitete të panjohura, apo janë rezultate që nuk është bërë testi antidoping fill pas fiksimit të rezultatit. Kohë më parë për këtë ka folur dhe Ajet Toska për shembull. Ju si e komentoni këtë?

Unë i kam dëgjuar kritikën, por atletika nuk e ka emrin Ajet Toska apo Gjergj Ruli. Atletika është sport i bukur dhe garat e saj bëhen në stadione. Unë këshilloj që të respektohet rezultati. Atletika i ka heronjtë e vet, çdo disiplinë i ka emrat e vet, por rekordet nuk janë të përjetshme, ato edhe do të thyhen kur dalin sportistë cilësorë. Atletika jonë i ka vënë piketat. Kur ishim sportistë na ka vlerësuar populli nëpërmjet anketave të kohës. Unë nuk jam për thumbimin e sportistëve, apo njolloshjen e tyre pa të drejtë. Rekordi i Toskës për shembull në hedhje çekiçi është thyer nga

Çollaku, rezultat i regjistruar në Finlandë. Unë nuk mendoj se Finlanda është një vend që merret me falsitete për një rezultat sportiv. Rekordi u thye kur Toska ishte sekretar në federatë. Unë kam ende një rekord për U-16 të pathyer, por nuk mburrem. Ju më pyetët për testin antidoping të këtyre sportistëve, por më falni, po ne sportistëve të asaj kohe kush na e bëri testin antidoping? Asnjë nga ne që kemi vendosur rekordet në atë kohë nuk ka bërë test antidoping.

Më falni, a ushtron sot për sot federata e atletikës kontrollë antidoping në qendrat stërvitore?

Në çdo kohë atletët e ekipit kombëtar kontrollohen. Doping u është i shumëllojtë dhe në ditët e sotme kjo çështje ka evoluar shumë. Sot konsiderohesh me doping edhe kur pi tre kafe të njëpasnjëshme. Doping është dhe kur përdor ilaçe të rekomanduara nga mjeku por në këto raste ka receta të verifikuara. Kur s'ka kartelë mjekësore është doping. Çdo substancë që rrit ndryshimin në trupin e njeriut është doping. WADA i ka qartësuar mirë rregullat. Vetë sportistët duhet të jenë vigjilentë. Kjo edhe për edukatën sportive të atletëve.

Kush janë sportistët me të cilët federata krenohet në këtë periudhë?

Sot për sot kemi disa elementë cilësorë me të cilët shpresojmë të arrijmë më shumë rezultate. Kështu, kemi një rizgjim të Adriatik Hoxhës në hedhje gjyleje, ku shpresojmë të kalojë të 19 metrat. Në kërcim së gjati ka një rivalitet të spikatur midis Toskës e Smalajt. Ky i fundit në Botërorin e Moskës bëri një paraqitje shumë të mirë dhe pavarësisht se njëra nga provat ishte faull, ai iu afrua kufirit të 8 metrave. Luiza Gega, të gjithë e dinë, ka hënë maksimumi në garat ndërkombëtare duke përfaqësuar me dinjitet Shqipërinë. Në garat motore jemi mirë, por kemi probleme në garat teknike, siç janë kërcim së larti, hedhje çekiçi, hedhje disku, kërcim me shkop etj. Pse jemi dobët? Sepse nuk kemi kushte. Disiplina të tilla kërkojnë mijëra metra katrorë terrene, gjë që nuk i disponojmë. Kërkojnë kushte pasi gara të tilla si disku, shtiza e çekiçi janë problematike pasi mund të aksidentohen njerëz në natyrë të hapur. Për kërcimin me shkop nuk kemi palestër dhe s'është bërë shtrati ku futet shkopi dhe kjo është problem më vete. Por ndihem krenar se në këto vite kam mundur të organizoj disa veprimtari ndërkombëtare dhe vitin e ardhshëm shpresojmë të kemi gjysmëmaratonën ndërkombëtare në Durrës. Është diçka e mirë për Shqipërinë.

A do ta ketë shansin Shqipëria të shkojë në Olimpiadën e Rios me sportistë me normë?

Me pak kujdes mund të kishim që tani të kualifikuar dy sportistë me normë. Por atletika e ka privilegjin për një mashkull e një femër sportiste. Megjithatë, unë mendoj se Hoxha në gjyle do e kapë normën. Edhe Smajlaj në kërcim së gjati ka të dhëna shumë të mira. Luiza Gega është avangardë te femrat. Kemi disa elementë, por asnjëherë nuk duhet të harrojmë kushtet ku operojmë. Italia ka 300 pista atletike dhe në Botërorin e Moskës nuk mori asnjë medalje. Ne patëm mundësinë të valëvitim flamurin shqiptar për 13 ditë me radhë në Moskë, por kur nuk fitoi Italia, pretendimi nga ne për medalje është i tepërt.

Çdo të bëhet me infrastrukturën e atletikës?

Në tetor nisim lotimin pranë qeverisë së re për të na bërë një pistë në kryeqytet, pasi kemi dhe vizita nga federata botërore. Qeveria aktuale nuk e mbajti premtimin e saj për pistë. Tirana në veçanti ka nevojë për më shumë pista. Në Korçë, ndihem krenar që ndikova drejtpërdrejt të kenë tashmë një pistë. Ne në kryeqytet duam një pistë pas “Sheratonit”. Ajo do të jetë një pistë mbarëkombëtare. Është dhe marketing që na vlen.

Diçka për të shtuar?

Dua të them se atletika është në rrugë të mbarë. Nuk duhet të kërkojmë qiçra në hell. Ata që e kritikojnë atletikën, duhet të vijnë ta shohin se ku operon e ç’rezultate ka. Buxheti që ne marrim nuk del as për gjyqtarët. Dhe ne na duhen dyfishi i gjyqtarëve që kemi. S’bëhet garat pa gjyqtarë. Unë këshilloj ta duam atletikën me shpirt, por jo duke e sharë. Një mendje e lirë dhe e mirë le të vijë e të na japë ide. Atletika nuk ka nevojë për stërkëmbësja. Ajo nuk i përket Gjergj Rulit, por është e të gjithëve. **Adriatik BALLA**

Burimi: <http://www.sot.com.al/intervista-sport/ruli-atletika-%C3%ABsht%C3%AB-gjall%C3%AB-po-thyhen-rekordet-e-plejad%C3%ABs-s%C3%AB-art%C3%AB>